




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT



NR. 9 AKTI

NR. 2 VENDIMI

Tiranë, më 16.02.2018

VENDIM

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Pamela Qirko	Anëtar
Olsi Komici	Relator


asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Olsida Goxhaj; pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryetarit dhe relatorit, sot, më datë 16.02.2018, ora 11:00, në sallën nr. 2 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Z. ADRIATIK XHEMAL LLALLA – ISH-PROKUROR I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BAZA LIGJORE : Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Nenet 14 dhe 57 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

Rrethanat e çështjes

Subjekti i rivlerësimit, Z. Adriatik Xhemal Llalla, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe si subjekt i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe



gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në referim të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit, Z. Adriatik Llalla, në cilësinë e Prokurorit të Përgjithshëm, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi në kohë, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur më datë 06.11.2017 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupës gjyquese të datës 13.11.2017 u deklarua mungesa e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ.

Konstatohet se mandati i subjektit të rivlerësimit, Z. Adriatik Llalla, në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm ka filluar në datën 07.12.2012, me dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr. 49/2012, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 19.12.2012. Këtë detyrë subjekti i rivlerësimit e ka ushtruar deri në datën 18.12.2017, kur me Vendimin nr. 115/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, “Për caktimin e prokurorit që do të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19.12.2017, është caktuar prokurori që do të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm.

Me mbarimin e mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në nenin 148/a, pika 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt rivlerësimi ka vazhduar.

Arsyet për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, Z. Adriatik Llalla, me shkresën datë 12.02.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. 1737 prot., datë 12.02.2018, të titulluar “Kërkesë”, informon këtë institucion se me shkresën e datës 10.02.2018 drejtuar Presidentit të Republikës ka kërkuar dorëheqjen nga e drejta që i njeh ligji për t’u caktuar në një pozicion Apeli. Në vijim të kërkesës, nga kërkuesi janë përmendur: a) neni 61 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet e drejta e tij që, pas mbarimit të mandatit, të caktohet në një pozicion në nivel Apeli; b) neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet dorëheqja e subjektit të rivlerësimit dhe detyrimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të ndërprerë procedurën; c) Vendimi nr. 78/2017 i Gjykatës Kushtetuese, duke



specifikuar pikën 43 të këtij vendimi: “Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”. Në këto kushte, kërkuesi i bën me dije Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se ka hequr dorë nga statusi i magjistratit dhe nga e drejta për t’u emëruar në një pozicion Apeli, duke kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, me shkresën nr. 381/1 prot., datë 12.02.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. 1795 prot., datë 12.02.2018, referuar kërkesës, nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 78/2017 të Gjykatës Kushtetuese, i dërgon Komisionit dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë kërkesën për dorëheqje të Z. Adriatik Llalla, drejtuar Presidentit të Republikës, nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta që i njeh ligji për t’u emëruar në një pozicion në Gjykatën e Apelit.

Procesi i rivlerësimit nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës dhe kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Ky proces nënkupton ngritjen e një sistemi rivlerësimi për subjektet e parashikuara në nenin 179/b/3 të Kushtetutës dhe përfshin të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm; Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen:

1. *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*
2. *Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

1. *Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.*
2. *Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.*



Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave si vijon:

“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.”

Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, Z. Adriatik Llalla, ka filluar në respektim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Me përfundimin e mandatit të subjektit të rivlerësimit si Prokuror i Përgjithshëm, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konkretisht pikës 5 të nenit 148/a, ai emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në Gjykatën e Apelit vetëm me një kërkesë të tij.

Në këto kushte, pavarësisht përfundimit të mandatit të tij kushtetues si Prokuror i Përgjithshëm, procesi i rivlerësimit ndaj tij ka vazhduar nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sepse e vetmja mënyrë për ndërprerjen e këtij procesi, që parashikon legjislacioni shqiptar, është dorëheqja.

Me paraqitjen e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. 1737 prot., datë 12.02.2018, Komisioni është vënë në dijeni të kërkesës për dorëheqje të subjektit të rivlerësimit “nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta që i njeh ligji për t’u caktuar në një pozicion Apeli”, drejtuar Presidentit të Republikës.

Ndëprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, ai humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit “G” të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,



Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, Z. Adriatik Xhemal Llalla, është ndërprerë.

Ky vendim u njoftohet: subjektit të rivlerësimit, Z. Adriatik Xhemal Llalla, Komisionerit Publik dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

ROLAND ILIA

Kryesues

PAMELA QIRKO

Anëtar



OLSI KOMICI

Anëtar

Ky vendim shpallet në datën 16.02.2018.